



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr 1432 Prot.

Gjirokastër, më 15.12.2020

Lënda: Përcjellje e raportit të veprimtarisë mësimore shkencore të FSHN-së për vitin akademik 2019-2020

ZV/REKTORIT PËR PROCESIN MËSIMOR

Prof. asoc. Dr. Jaho CANA

ZV/REKTORIT PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR

Prof. asoc. Dr. Valbona DURI

KËTU

Bazuar në Vendimin nr. 9 datë 15.12.2020 të Dekanatit, po ju përcjellim Raportin e Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të FShN-së për vitin akademik 2019-2020.

Dekan

Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr 1451 Prot.

Gjirokastër, më 15.12.2020

VENDIM

NR. 9 DATË 15 / 12 / 2020

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË MËSIMORE-SHKENCORE TË FSHN-së
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Mbështetur në Raportet e Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të Përgjegjësave të Njësve Bazë / Departamenteve të FSHN-së për vitin akademik 2019-2020, Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020

VENDOSI

Të miratojë Raportin e Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të FSHN-së për vitin akademik 2019-2020.

Dekan

Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 1430 Prot

Gjirokastrë, më 15 / 12 / 2020.

**RAPORT MBI VEPRIMTARINË MËSIMORE KËRKIMORE TË
FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS PËR VITIN 2019-2020**

Raporti i veprimtarisë mësimore e kërkimore të FSHN, është hartuar bazuar mbi raportet e departamenteve përkatëse, si dhe në ndjekjen e përditësuar të realizimit të procesit mësimor e kërkimor, në vëzhgime, në analiza dhe kontrole, si dhe në vlerësimin e dokumentacionit ligjor nga strukturat drejtuese të fakultetit.

Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raport i vlerësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse.

Fushat kryesore të veprimtarisë së FSHN gjatë vitit 2019-2020:

1. Realizimi i plotë dhe me cilësi i procesit mësimor edhe në kushtet e mësimdhënies online gjatë semestrit të dytë.
2. Përmirësimi i teknikave të mësimdhënies dhe veçanërisht mësimdhënia nëpërmjet platformave online ka qenë këtë vit një domosdoshmëri në kushtet e mbylljes së auditoreve prej pandemisë Covid-19.
3. Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
 - a) Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare
 - b) Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
4. Plotësimi i saktë dhe në kohë i dokumentacionit përkatës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor. Dokumentimi i zhvillimit të procesit mësimor online në formatet e materialeve të shkruara ose multimediale të shkëmbyera me studentët nga ana e pedagogëve në platformat online.



5. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi (akademik dhe ndihmës) dhe infrastruktura e laboratoreve për studentët ka qenë në vazhdimësi si çdo vit. Por në kushtet e zhvillimit online të procesit mësimor (semestrin e dytë), pedagogët janë sforcuar që të kryejnë praktikat laboratorike të disiplinave që zhvillohen në programet e studimit të FSHN-së, duke përdorur laboratorët virtualë, duke i mëshuar më shumë përgatitjes teorike. Kjo mangësi është kompensuar në periudha të dedikuara për zhvillimin e praktikave laboratorike në auditorë para sezonit të provimeve.
6. Marrja e masave për minimizimin e problematikave të konstatuara.
7. Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentët e diplomuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.
8. Bashkërendimi i veprimtarisë mësimore midis Njësive Bazë të Fakultetit dhe të universitetit.
9. Intensifikimi i bashkëpunimit midis Njësive Bazë në funksion të veprimtarive kërkimore ndërdisiplinare.
10. Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit.

Stafi akademik i FSHN është i aktivizuar në një masë të konsiderueshme (mbi 50%) mësimdhënieje, në tre programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional (që i mbulon FESHSH).

Personeli i punësuar në FSHN (referuar organogramës së FSHN për vitin akademik 2019-2020) përbëhet nga:

31 punonjës personel akademik,
2 punonjës personel administrativ,
7 punonjës personel ndihmës mësimor-shkencor.

Në Tabelat më poshtë është shpjeguar që gjatë vitit akademik 2019-2020, pranë FSHN janë aktivizuar 31 personel akademik me kohë të plotë (i brendshëm), 26 personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) si dhe 3 personel akademik i ftuar.

Gjithashtu pasqyrohet numri i personelit akademik të brendshëm sipas kategorive, të cilët janë aktivizuar në secilën njësi bazë të FSHN gjatë vitit akademik 2018-2019.

Tabela 1 Personel akademik i aktivizuar pranë FSHN

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Dep. Biologji Kimisë	8		
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	15	4	1
Dep. Infermierisë	8	17	1
TOTAL FSHN	31	26	3

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor

Dep. Biologji Kimisë	5	2	1
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	1	9	5
Dep. Infermierisë	1	2	5
TOTAL FSHN	7	13	11

Realizimi i ngarkesës mësimore të normuar

Ngarkesa mësimore e normuar e stafit akademik në FSHN, në zbatim të Udhëzimit 29 datë 10.09.2018 të MASH, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", (ndryshuar me Udhëzimin 36 datë 23.11.2018, ndryshuar me Udhëzimin 37 datë 04.12.2018), është realizuar në përputhje me planet mësimore, të miratuara nga Senati akademik i UGj-së.

Ngarkesa mësimore është realizuar nga personeli akademik me kohë të plotë i FSHN dhe personeli akademik me kohë të pjesshme (si dhe pedagogët e ftuar) të aktivizuar pranë FSHN. Realizimi i ngarkesës është kryer sipas kriterëve të mëposhtme:

- *Plotësimi 100% i ngarkesës mësimore për të gjithë personelin akademik me kohë të plotë dhe tejkalimi i saj, në përputhje me udhëzimet e MASR.*
- *Aktivizimi i personelit akademik me kohë të pjesshme, në varësi të kualifikimit, për plotësimin e nevojave të departamenteve të FSHN, duke realizuar maksimalisht deri në 120 orë mësimore.*

Procesi Mësimor

Nga analiza në departamentet e FSHN në lidhje me procesin mësimor vihet re:

- Realizimi i plotë i procesit mësimor të vitit akademik 2019-2020 dhe përgatitja për realizimin pa probleme të procesit mësimor të vitit akademik 2020-2021. Procesi mësimor në semestrin e dytështë zhvilluar në distancë (online) në zbatim të udhëzimeve të MASR dhe urdhërave të Rektorit të periudhës mars 2020, në kushtet e pamundësisë së zhvillimit në auditorë prej pandemisë Covid-19.
- Hartimi i planeve kalendare sipas planifikimit kohor dhe përmirësimi i programeve lëndore për disiplinat përkatëse.
- Përmirësimi i materialeve mësimore të disiplinave sipas çdo programi për të qenë koherent me kërkesat e teknologjise së prezantimit dhe të informimit sipas përmbatjes.
- Hartimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket tekstesh mësimore dhe laboratorike bashkëkohore në informacion dhe konceptim.

Përmirësimi i materialeve mësimore të lëndëve përkatëse sipas çdo programi për të qenë koherent me kërkesat e teknologjise së prezantimit dhe të informimit sipas përmbatjes.

Procesi mësimor i semestrit të parë është zhvilluar pranë auditoreve të Universitetit. Procesi mësimor i semestrit të dytë perkoi me masat e ndërmarra nga institucioni ynë, në kushtet e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Pandemia e Covid-19, për përmbylljen me sukses të vitit akademik 2019-2020 dhe për pasojë mësimi u zhvillua në distancë (online), duke përdorur platformat ueb të mësimdhënies si Classroom, Edumeet dhe Zoom. Edhe pse një formë e mësimdhënies, me gjithë vështirësitë e hasura si pasojë e aftësive në përdorimin e këtyre platformave, si dhe problematikave në infrastrukturën e nevojshme për përdorimin e tyre nga ana e stafit akademik dhe studentëve, procesi mësimor u realizua me sukses. Bazuar në Udhëzimin Nr. 104 datë 30.04.2019 të MASR-it para sezonit të provimeve për disa javë u zhvilluan gjithashtu një

cikël përmbledhës për përsëritjen e leksioneve si dhe zhvillimi i orëve laboratorike të programeve mësimorë në auditoret e Universitetit.

Problematika të hasura gjatë zhvillimit të procesit mësimor

- Niveli i ulët shkencor i studentëve (vështirësia e lëndëve të shkencave natyrore, etj.).
- Frekuentimi i ulët i leksioneve nga ana e studentëve (Mungesa e infrastrukturës, mungesa e dixhitalizimit të procesit mësimdhënës, cilësia e mësimdhënies, të qenit fakultativ i leksioneve). Kjo është ndikuar dhe prej mbylljes në semestrin e dytë prej pandemisë Covid-19. Në kushtet e mësimin në distancë një numër studentësh e kanë patur të pamundur të frekuentojnë rregullisht mësimin.
- Politika e liberalizimit të frekuentimit të mësimin sidomos në përqindjen e ndjekjes së tyre dhe mos penalizimi në fund të vitit, madje duke krijuar akses hyrje në provim në vjeshtë, kanë influencuar ndjeshëm në braktisjen e procesit mësimor. Por dhe stafi në disa raste është treguar jo ekzigjent në cilësimin e orës së mësimin si të shenjtë dhe se çdo student që paraqitet kërkon dhe jemi të detyruar ti ofrojmë dije cilësore.
- Përgatitja dhe aktivizimi i studentëve në seminare e laboratore le shumë për të dëshiruar, gjë që e bën punën e pedagogëve jo shumë efektive dhe pengon shfrytëzimin efektiv të kohës prej tyre;
- Gjithashtu problem i mprehtë që është agravuar së tepërmi vitet e fundit është mungesa apo amortizimi i paisjeve laboratorike. Kjo i detyron pedagogët të ndërtojnë seanca laboratorike më fleksibël. Ndërsa për semestrin e dytë (mësimi online) ka qenë pothuajse e pamundur zhvillimi me efikasitet të plotë i seancave të praktikave laboratorike. Megjithatë ky problem është zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme në kushtet e mbylljes prej pandemisë, duke krijuar orare të posaçme, për grupe të vogla studentësh, të cilët zhvilluan praktikat laboratorike në auditorë pas rikthimit në shkollë, në verë për studentët e viteve përmbyllëse dhe në vjeshtë për studentët e viteve të ndërmjetme.
- Përshtatje e strukturës mësimore të vitit akademik në mënyrë që të rekuperohen mangësitë e zhvillimit efikas të procesit mësimor online. Strukturat mësimore u përshtatën sipas specifikave të secilës Njësi Bazë për plotësimin/përsëritjen e njohurive të marra online dhe veçanërisht për kryerjen e praktikave laboratorike dhe atyre profesionale.

Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive

Nga analiza në departamentet e FSHN vihet re:

- Hartimi dhe miratimi i tezave të provimit.
- Realizimi i provimeve konform rregullores së FSHN dhe UGJ (tezat me 5 variante, përfshirja në vlerësimin përfundimtar e vlerësimit të vazhduar, fletoret e sekretuara, vlerësimi analitik, orari i provimit, plotësimi i procesverbaleve dhe hedhja e notave në sistem) dhe formave të tjera të kontrollit. Janë hasur disa problematika teknike që lidhen me sa më sipër.
- Gjatë semestrit të dytë sezoni i parë i provimeve (pas përsëritjes/plotësimit në auditor të programit lëndor) është zhvilluar në periudhën e verës për studentët e viteve përmbyllëse dhe në periudhën e vjeshtës për studentët e viteve të ndërmjetme.

Problematika të hasura gjatë kontrollit dhe vlerësimit të njohurive

- Problem deri diku ka qenë komunikimi i rezultatit të provimit të studentët dhe hedhja e notave në sistem. Këto anomali kanë ardhur shpesh nga mos funksionimi i sistemit.
- Komisioni i provimit në disa raste ka përdorur edhe vlerësimin total ku nuk evidentohet saktë vlerësimi analitik i studentit për çdo pyetje dhe është vërejtur mos pjesëmarrja aktive e anëtarit të dytë të komisionit në korigjimin e fletoreve.
- Janë hasur raste kur për shlyerjen e detyrimeve “firmë” nuk zbatohet me korrektësi rregullorja për vlerësimin e vazhduar dhe progresiv (ndodh që bëhet vetëm një vlerësim përfundimtar në mbyllje të semestrit).
- Mbingarkesë e pedagogëve ekzistues në angazhimin në komisionet e provimit gjatë provimeve të sezonit të vjeshtës për disiplinat/modulet fizikë, për shkak të largimit në pension apo pamundësisë për t’u aktivizuar në këto komisione të personelit akademik të jashtëm.
- Nga analiza pamore e procesverbaleve rezulton se ka një nivel të ulët të përgatitjes së studentëve në çfaredolloj forme vlerësimi.

Masat për fillimin e vitit akademik 2020-2021

- Janë hartuar kriteret e pranimi të maturantëve në programet specifike të FSHN.
- Është njohur stafi i departamentit me udhëzimet e ministrisë dhe institucionit tonë për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesi mësimor në fomen e mësimdhënies në distancë.
- Është bërë trajnimi dhe ka nisur mesimdhënia nëpërmjet platformës online Office 365 nga stafi akademik.
- Bazuar ne Udhëzimin Nr.29, date 10.09.2018 “Per veprimtarine dhe ngarkesen mesimore te personelit akademik ne Institucionet e Arsimit te Larte” është kryer fillimisht një ndarje paraprake e ngarkesës mësimore. Ka qenë e pamundur të bëhej një tabelë përfundimtare për ngarkesën mësimore të personelit akademik ndërsa nuk kishte përfunduar procesi i regjistrimit të studentëve në vitet e para në programet e studimit të ciklit të dytë në FSHN duke mospasur një vendim final për funksionimin ose mos-funksionimin për këtë vit akademik të disa viteve të para të programeve të studimit të mësuesisë si dhe për programet e studimit të ciklit të dytë.
- Ndarja e ngarkesës mësimore ka përfunduar pas mbylljes së afateve të regjistrimit të studentëve në gjithë programet e studimit të FSHN-së.
- Në kuadrin e mësimi në distancë (online) për fillimin e vitit akademik 2020-2021 janë marrë masat për mirëfunksionimin e këtij procesi. Janë zhvilluar trajnime me pedagogët për funksionimin e platformës Microsoft TEAMS.
- Po punohet për hartimin e planeve kalendare përkatëse, programeve të rinovuara konform planeve mësimore që zbatohen në secilin program studimi dhe marrëveshjet e normimit vjetor të punës së stafit akademik.
- Vazhdon puna e stafeve akademike për të mundësuar sigurimin e bazës materiale shkencore të shkruar për studentët e secilit program studimi.

Me qëllim rritjen e performancës së FSHN në përmbajtje, një punë e mirë është bërë nga personeli akademik dhe ndihmës, përgjegjësat njësive bazë dhe grupeve mësimore në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programeve mësimore që ofron Njësia Kryesore.

Meqënëse u bënë disa vite që numri dhe cilësia e studenteve që aplikojnë për studime në programet që ofron FSHN ka rënë, politika jone ka synuar në informimin masiv për mundësitë që ofrojnë programet tona, gadishmërinë dhe cilësinë e stafit, lehtësirat procedurale që ofrojmë në

rast integrimi programesh, kur vijnë nga degë të përafërta dhe që kanë ndërprerë studimet, si dhe fleksibiliteti i zhvillimit të programit përkatës.

Për të mundësuar vijueshmëri në sasi dhe cilësi, vëmendja e punës së stafit ka qenë informimi dhe marrdhënia me studentet, ku që në fillim të vitit akademik janë njohur me planin mësimor, programin e studimit, rregulloren e departamentit, Universitetit, statutin dhe të gjithë elementet teknike të mbarëvatjes së procesit mësimor.

Problematika të hasura gjatë marrjes së masave për fillimin e vitit akademik 2020-2021

- Në disa raste është vënë re mospërputhje midis kualifikimit shkencor të stafit akademik me disiplinën / modulën që zhvillon (për arsye të stafit të kufizuar)
- Në disa raste në planet kalendare të disiplinave të caktuara ka mospërputhje kohore midis temave të leksioneve dhe seminareve/laboratoreve.
- Rënia e numrit të orëve për shkak të numrit shumë të vogël të studentëve (mos-hapja e disa programeve të studimit të mësuesisë)
- Ka patur raste të përfshirjes me vonësë të studentëve në klasat online për arsyet teknike të funksionimit të adresave elektronike të tyre brenda domain-it të UoGJ, të cilat janë kapërcyer në bashkëpunim me Sektorin e Standardeve dhe Kurrikulave si dhe me IT e universitetit.

Zhvillimi i praktikave

a) Praktika mësimore (Departamenti i Infermierisë)

- Praktikën mësimore janë zhvilluar në përputhje me kontratat e lidhura midis institucionit tonë dhe drejtorive përkatëse të Spitalit rajonal dhe të Shëndetit Publik, për sa i takon orëve të parashikuara për tu zhvilluar në semestrin e parë. Për orët e praktikave profesionale të Infermierisë të parashikuara për semestrin e dytë, një pjesë e tyre janë zhvilluar para mbylljes prej pandemisë dhe diferenca është zhvilluar duke ndarë me studentët online materialin teorik të shkruar apo materiale multimediale.
- Në kushtet e reja të diktuar nga prania e pandemisë Covid-19 plotësimi/përsëritja e praktikave mësimore është kryer në laboratorët e Departamentit të Infermierisë konform protokolleve anti-Covid.
- Një punë të mirë dhe raport mjaft komunikues është ndërtuar me infermierët "mentor" për të cilët duhet vlerësuar efikasiteti me studentët tanë.
- Ndjekja e praktikave është bërë nga stafi akademik me kohë të plotë, të pjesshme pranë pavioneve, qendrave shëndetësore, etj. sipas marrëveshjeve përkatëse.

b) Praktika profesionale (Dep. e Matematikës Informatikës dhe Fizikës dhe Dep. Bio-kimisë)

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në lidhje me studentët e ciklit të dytë që zhvillojnë praktikën profesionale është planifikuar shpërndarja nëpër Drejtoritë Arsimore rajonale përkatëse, janë pajisur me materialet e nevojshme që sigurojnë mbarëvatje të procesit pedagogjik, për mundësi kontrolli për rezultatet e punës së tyre. Një element pozitiv në këtë drejtim ka qenë bashkëpunimi me drejtuesit e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 edhe pse në kushtet e gjatës së fatkeqësisë natyrore, të shkaktuar nga Pandemia e Covid-19, u realizua me sukses praktika profesionale nga studentët e programeve të ciklit të dytë të studimit Master në Mësuesi.

Praktikën profesionale studentët e zhvilluan pranë auditoreve të Universitetit, nën drejtimin e pedagogeve metodistë të caktuar si të tillë prej Njësisë Bazë, ku njëri prej kandidatëve luajti rolin e mësuesit, kurse pjestarët e tjerë e të grupit ishin në rolin e nxënësit, në bazë të një rotacioni ose grafiku të përcaktuar qysh me parë nga pedagogu metodist. Në përfundim të praktikës profesionale u realizua dhe vlerësimi i ecursë dhe rezultateve të studentëve.

c) Praktika në terren (Departamenti i Bio-kimisë)

Edhe pse në kushtet e mbylljes prej pandemisë Covid-19, duke mos qenë të kushtëzuar nga prania fizike në auditorë, janë zhvilluar praktika në terren nga studentët e degës Biologji-Kimi (Bachelor), ku është synuar (në kushtet e vështira të mundësisë për të lëvizur), të merret një rezultat sa më i kënaqshëm. Në tërësi praktika në terren është realizuar.

Në tërësi stafi i FSHN-së ka qenë bashkepunues në zhvillimin e procesit mësimor. Kjo ka konsistuar në realizimin e detyrave personale të ngarkuara për çështje të veprimtarisë së Fakultetit në këtë fushë. Elementët e veprimtarisë ditore janë konkretizuar me korrektësi, dhe për rastet e veçanta janë marre masa sikurse këshillime dhe qortime.

Problematika të hasura gjatë zhvillimit të praktikave

a) Praktika mësimore (Departamenti i Infermierisë)

- Ka patur vështirësi në ndarjen në nën grupe për zhvillimin e praktikave gjatë punës në spital dhe qendra shëndetësore për semestrin e parë.
- Baza materiale e pamjaftueshme në spital dhe qendra shëndetësore nuk mundëson zhvillimin real praktik të disa temave në disa disiplina të caktuara.
- Në pamundësi për tu zhvilluar pranë Spitalit Rajonal apo qendrave shëndetësore orët e praktikave profesionale të Infermierisë të parashikuara për semestrin e dytë, janë zhvilluar duke ndarë me studentët online materialin teorik të shkruar apo materiale multimediale.

b) Praktika profesionale (Dep. e Matematikës Informatikës dhe Fizikës si dhe Dep. Bio-kimisë)

- Stafi akademik i FSHN ka vështirësi në ndjekjen e praktikës profesionale afatgjatë për arsye të angazhimit në universitet me mësimdhënien e disiplinave të tjera.
- Ka qenë e pamundur zhvillimi i praktikave pedagogjike nga ana e studentëve të ciklit të dytë (master profesional) pranë shkollave të AMU për shkak të pandemisë Covid-19. Kjo është kapërcyer nga pedagogët duke ndarë me studentët materialet teorike të shkruara dhe praktikisht duke zhvilluar secili student praktikë pedagogjike (mësimdhënie) duke patur si "nxënës" studentët e tjerë të kursit.

c) Praktika në terren (Departamenti i Bio-kimisë)

- Financimi i pamjaftueshëm për udhëtime dhe bazë materiale ka vështirësuar zhvillimin me cilësi të lartë të praktikave në terren.
- Baza materiale e amortizuar nuk lejon zhvillimin me cilësinë e pretenduar të këtyre praktikave.
- Në kushtet e mbylljes prej pandemisë Covid-19, janë realizuar praktikat në terren duke mos qenë të kushtëzuara nga prania fizike në auditorë.



Detyrat për të ardhmen

- Vazhdimësia dhe përmirësimi i komunikimit dhe informimit të studentëve që diplomohen në programet e studimit pranë fakultetit tonë.
- Inkurajimi dhe shtimi i numrit të pedagogëve të FSHN që përfshihen në projekte kërkimore me partnerë shqiptarë dhe të huaj. Në këtë aspekt vëmendje duhet të tregohet në përfshirjen edhe të studentëve në aktivitete specifike të projekteve. Gjithashtu përfshirja në projekte mundëson sigurimin e financimeve për aktivitete të ndryshme mësimore dhe pasurimin e bazës materiale laboratorike.
- Të vazhdohet puna për përdorimin në vazhdimësi të burimeve të informacionit sa më bashkëkohorë dhe atraktive, sidomos në lendet përshkruese. Kjo merr peshë të veçantë në kuadrin e mësimdhënies online nëpërmjet platformave kompjuterike.
- Të insistohet për sigurimin e një procesi mësimor sa më atraktiv me bazë didaktike sa më bashkëkohore dhe shkencore, megjithëse vazhdon vështiresia e sigurimit të literaturës së duhur konform kërkesave të stafit nëpërmjet fondit të akorduar nga universiteti, për të cilin duhet të investojmë akoma më shumë në të ardhmen.
- Modernizimi drejt dixhitalizimit i metodave mësimdhënëse. Kjo vlen veçanërisht në laboratorët e fizikës të cilët në pamundësi për tu pajisur me dispozitivë modernë e të shtrenjtë, mund të zhvillohen me cilësi të lartë duke shfrytëzuar laboratorët virtualë.
- Përshtatja e realizimit të procesit mësimdhënës nga ana e pedagogëve, dhe mësimnxënës nga ana e studentëve, nëpërmjet mësimin në distancë online në kushtet e pandemisë Covid-19.
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e platformave të mësimin online.
- Përforcimi i punës në aspektin e tretë të veprimtarisë universitare: ndërveprimi me biznesin dhe komunitetin përveç dy aspekteve të tjera: mësimdhënies dhe kërkimit.

Informacion mbi bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë Fakulteti (IAL-ja) ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; kontratën; datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit ; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim

- Në programet e studimit të ciklit të dytë vazhdon bashkëpunimi me FESHSH që ndjek në mënyrë të drejtpërdrejtë ecurinë e studimeve në këtë cikël.
- Është rritur niveli i bashkëpunimit me fakultete homologe të universiteteve të tjera shqiptare që kanë programe të ngjashme studimi për gjithë aspektet e punës akademike. (Universitetet e Elbasanit, Shkodrës, Korçës dhe Vlorës).
- Është bashkëpunuar ngushtësisht me instancat përkatëse të MASR për implementimin e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015.

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka qenë partner në projektin TEANET: Developing Teacher Competencies for a Comprehensive Vet System in Albania. Erasmus+.

15.10.2017–14.10.2020. Project Reference: 586300-EPP-1-2017-ES-EPPKA2-CBHE-SP.
<https://teavet.org/about/>

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës vazhdon të implementojë si partner, projektin ndërkombëtar "TECOMP: Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences" <http://www.tecomp.ni.ac.rs/project-teams/> (Nëntor 2018-Nëntor 2021). Në kuadrin e këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka fituar aplikimin pranë AKKSHI për të implementuar projektin kërkimor për "aplikimin e ICT në mësimdhënien e ICT", (Shtator 2019-Qershor 2020), në kuadër të të cilit do të kryhet kërkim shkencor në lidhje me ndërtimin e një modeli inovativ të mësimdhënies së ICT nëpërmjet ICT masivizimit të YPS, mbledhjes dhe analizes së të dhënave dhe matjes së njohurive të studentëve; me drejtues projekti, Doc. Dr. Romeo Mano (Seksioni i Analizes dhe Matematikes se aplikuar).

Informacion mbi kërkimin shkencor në Fakultet –IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive cili përfshin:

Krahas punës për zhvillimin me korrektësi dhe cilësi të mësimdhënies, personeli akademik i FSHN i ka kushtuar një vëmendje mjaft të madhe veprimtarisë kërkimore-shkencore (individuale dhe në grup) me qëllim kualifikimin e mëtijshëm shkencor.

Veprimtaria kërkimore-shkencore si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të departamenteve të FSHN është përqëndruar në këto drejtime:

- Paraqitja e arritjeve të punës kërkimore nëpërmjet botimeve në revista shkencore apo referimeve në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Zhvillimi i kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe Ligjit të Arsimit të Lartë.
- Ndjekja e workshopeve dhe trajnimeve online veçanërisht në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënien në universitet në kuadrin e projekteve të përbashkëta me partnerë të huaj.
- Pjesëmarrja në veprimtari jashtë universitare të lidhura me performancën arsimore.

Më poshtë paraqiten të dhëna për aktivitetin kualifikues, botues, pjesëmarrës dhe referues (me gojë ose poster) në konferenca dhe aktivitet tjetër shkencor nga anëtarët e stafit akademik të FSHN sipas departamenteve:

Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë

1. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punes kualifikuese per titull Prof.dr. (S. Malo, S.Oruci, G. Paspali. M. Terpo)
- Vazhdim i punes kualifikuese per titull Prof.asoc (E. Hysaj, A. Qendro).
- Vazhdimi i punes ne kuader te disertacionit te doktorates (A. Como).
- Prezantime ne vazhdueshmeri te punes kerkimore dhe shkencore ne te gjitha aktiviteti mundhsme brenda dhe jashte vendit
- Nje nga fushat e veprimtarise kerkimore ku rezultatet jane manifestuar eshte botimi i punimeve kerkimore ne fusha te ndryshme duke i prezantuar ne revista shkencore dinjitoze brenda dhe jashte vendit, madje dhe me faktor impakti dhe kongrese nderkombetare.

vit numuri i artikujve dhe pjesmarrjes ne konferenca kombetare dhe n/kombetare nuk ka qene i kenaqshem, ndoshta kjo e ndikuar dhe nga shpenzimet e larta qe ato kane. Megjithate per tu rritur akoma dhe me tej niveli dhe cilesia e punes kerkimore dhe shkencore duhet qe patjeter te gjenden rruge dhe mjetet e duhura financiare per ecurine pozitive te ketij aspekti. Madje nga ana e Pergjegjesit te Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë ne menyre institucionale eshte kerkuar nje mbeshetje me praktike dhe me efikase nga ana e institucionit. Ndikim ka pasur dhe situata e pandemese e cila ka penguar levizjen e personelit akademik dhe nga situata financiare.

2. Aktivitet tjetër shkencor

- Rishikimi ne strukture dhe permbatje i programeve mesimore te disiplinave/moduleve qe perfshihen ne programet e studimit te ciklit te dyte (i gjithe stafi i departamentit)
- Ekspedita per hulumtime dhe grumbullim materiali kerkimor dhe zhvillim analizash laboratorike (stafi akademik).
- Kryerja e hulumtimeve dhe studimeve ne bashkepunim me studentet e programit Bachelor.
- Pjesëmarrja ne vazhdimesi në projekte kërkimore kombëtare, por kjo kërkon dhe sigurim financimi te planifikuar nga sektori i kërkimit shkencor në rang universiteti.
- Megjithese mbi 90% e stafit te departamenti eshte ne nje proces te vazhdueshem pune kerkimore me kerkime, analiza, ekspedita, pjesmarrje, botime, referime, etj Njësia Bazë synon qe puna kerkimore, te jete sa me aktive duke mundesuar kushte sa me te pershtatshme (megjithese nje pjesetar i stafit per shkak te moshes dhe arsyeve kohore e ka nderprere punen kerkimore).
- Njësia Bazë synon perfshirjen e studenteve ne grupe pune kerkimore per te qene pjese aktive dhe vijushmerie e kerkimit universitar, kjo sidomos per studentet e programit te ciklit te dyte Master i Shkencave. Kjo do t'i shërbejë dhe per promovimin e veprimtarise se departamentit nepermjet pjesmarrjes ne diskutime mediatike, aktivitetete universitare dhe me gjere

Një pjesë e mirë e stafit të departamentit zhvillon procesin mësimor në degë të tjera ku janë hartuar programe dhe plane kalendarike bashkëkohore. Por në tërësi realizimi i procesit mesimor ka akoma vend për përmirësime të mëtejshme cilësore dhe sasiore. Kështu në seancat ushtrimore dhe laboratorike studentëve duhet që t'u ofrohet literature dhe bazë materiale më e bollshme për demonstrime dhe përfitim shprehish pune. Është insistuar për menyren e organizimit te seancave laboratorike duke ndertuar seanca me fleksible ne permbatje dhe me te realizuara dhe ne kete menyre programi eshte bere me i prekshem nga studentet por shume me praktik. Oret e praktikave dhe ushtrimeve duhet te konceptohen variabël për tju përgjigjur nivelit të studentëve. Realizmi i praktikave mësimore eshte organizuar dhe planifikuar si një proces mësimor më i detajuar me detyra studentore ditore dhe jo përfundimtare. Matja e punës në praktikë eshte bere me konkrete dhe kjo eshte realizuar fal pervojes se grumbulluar duke ju ofruar nje strukture shume me kompetitive dhe qe mundeson kontrollin indirekt te punes se pavarur te studenteve. Kjo eshte gjetur si zgjidhje nga menyra e organizimit te praktikave me zhvendosje nga kontrolli direkt i stafit te pedagogeve.

Per nje organizim sa me te mire te procesit mesimor gjate viti 2020 u organizuan nje rishikim total i bazes materiale laboratorike me qellim njohjen e gjendjes dhe per nje organizim sa me te mire te procesit te metejshe mesimor, me qellim shfrytezimin e baze ekzistuese ne menyre sa te mundshme maksimale.



Departamenti i Matematikës Informatikës dhe Fizikës

1. Rezultatet e punës kërkimore shkencore:

- a) Gjatë vitit akademik 2019-2020 ka vijuar puna për perfeksionimin e ciklit të leksioneve në strukturë, përmbajtje dhe mënyrën e realizimit të tyre si në auditore ashtu edhe në përdorimin e formave elektronike të mësimi, për disiplina të programeve të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master në Mësuesi.
- b) Përmirësimi i programeve mësimore është zhvilluar tërësisht konform kërkesave të udhëzimeve dhe ligjeve përkatëse.
- c) Kualifikimi individual ka qënë pjesë e punës vjetorë të stafit. Aktualisht nga 15 anëtarë të stafit akademik të Departamentit për vitin akademik 2019-2020, 1 është Prof.asoc, 3 janë Doc.Dr. 1 është Doc.M.Sc, 5 janë Dr., 3 janë në proces doktorate dhe 2 janë M.Sc (në pritje të hapjes nga MASR të shkollës së doktoratave).
- d) Pjesë e veprimtarisë vjetore ka qënë dhe pjesëmarrja aktive dhe pasive në konferenca ndërkombetare e kombëtare brenda dhe jashtë vendit si dhe botimi në revista shkencore ndërkombëtare e kombëtare.

2. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punës kualifikuese për titull Prof.Asoc. (A. Isufati, K. Naka, R. Mano, K. Zoto, Dh. Terpo, A. Sinani, I. Kokalari)
- Vazhdimi i punës në kuadër të disertacionit të doktoratës (R. Vasili, B. Rama, I. Selmani)
- Në pritje për regjistrim dhe fillim të studimeve në shkollën e doktoratës (K.Lili, I. Bilo).

3. Aktivitet tjetër shkencor

Ka vazhduar veprimtaria si anëtar bordesh editoriale në periodikë brenda vendit:

- Anëtarë të Bordit Editorial “KERKIME UNIVERSITARE”: PERIODIKU “MATEMATIKA DHE SHKENCAT E NATYRES”.
- Anëtar në Komisionet e Provimeve të Shtetit në profesionet: “Mesues në Matematikë Informatike” dhe “Mesues në Informatikë” (A. Isufati).

Departamenti i Infermierisë

Risi këtë vit është dhe miratimi i programit të “Master profesional në shkencat infermierore” me Urdhërin nr.271, datë 28.08.2020 të MASR për të cilin stafi akademik po punon për të përgatitur bazën materiale shkencore (ciklet e leksione) për të qënë sa më koherent me informacionin .

1. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punës kualifikuese për titullin Prof. (M. Agolli)
- Vazhdim i punës kualifikuese për titull Prof.Asoc (Z. Vllaho, L. Mezini)
- Vazhdimi i punës në kuadër të disertacionit të doktoratës (A . Goxharaj , D. Rami, Zh. Graçi)
- Në pritje për regjistrim dhe fillim të studimeve në shkollën e doktoratës (A. Xhemali, M. Llavdaniti, P. Barjami).
- Kualifikimi individual ka qënë pjesë e punës vjetorë të stafit. Aktualisht nga 10 anëtarë të stafit akademik të Departamentit për vitin akademik 2019-2020, 1 është Prof.asoc, 1 është Doc.Dr, 1 është Dr, 1 është Master Ekzekutiv , 3 janë në proces doktorate dhe 3 janë M.Sc (në pritje të hapjes nga MASR të shkollës së doktoratave).

2. Aktivitet tjetër shkencor

- Pjesë e veprimtarisë vjetore ka qënë dhe pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare e kombëtare brenda dhe jashtë vendit si dhe botimi në revista shkencore ndërkombëtare e kombëtare.

Probleme të evidentuara nga analizat me departamentet e FSHN

- Të shikohet mundësia e financimit të pjesëmarrjes së pedagogëve në konferenca të ndryshme ndërkombëtare apo botimeve shkencore në revista të njohura.
- Rritja e aksesit online në revista të specializuara me abonim dhe financimi i kërkimit shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare apo ndërkombëtare. Kjo lidhet ngushtë edhe me sigurimin e fondeve për investime kapitale, sepse siç dihet pajisjet kërkimore kërkojnë burime financiare të larta, veçanërisht për laboratorët didaktike e kërkimore të Biologji-kimisë dhe Fizikës. Në këtë aspekt ka ndikuar pozitivisht frekuentimi / shfletimi i bibliotekës digjitale <https://ulibrary.rash.al/> nga ana e stafit akademik dhe studentëve të UGJ.

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR AKTIVITETIN KËRKIMOR - SHKENCOR TË PERSONELIT AKADEMIK TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS (Viti Akademik 2019-2020)

Nr.	Emertimi i zerave	Nen/zera	Sasia në n/zera	Sasia në total	Verejtje
1.	Artikuj shkencore	Brenda vendit	3	10	
		Jashtë Me Faktor Impakti	4		
		Vendit Pa faktor Impakti	3		
2.	Referime në Konferenca shkencore	Kombetare	1	8	
		Nderkombetare	7		
3.	Referime në Konferenca të botuara në Proceedings	Kombetare		13	
		Nderkombetare	13		
4.	Tekste universitare		5	5	
5.	Tekste parauniversitare				
6.	Tekst-maket universitar		1	1	
7.	Cikle leksionesh		10	10	
8.	Monografi				
9.	Udheheqje shkencore	Doktorature			
		Master Shkencor/Profesional			
		Diplome Bachelor			
10.	Oponence	Bachelor, Master/ Profesional & Shkencor			
		Doktorature			
11.	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (pa referim)	Konferenca		2	
		Ëorkshope			
		Seminare etj.	2		
12.	Leksione të hapura në UGJ / Universitete të tjera				
13.	Trajnim i stafit akademik		5	5	
14.	Trajnime të mesuesve		2	2	
15.	Aktivitete të organizuar në UGJ		3	3	

16.	Aktivite te organizuar me aktore te tjere(university, qendra kerkimi dhe locale)				
17.	Plane mesimore	Hartime te reja			
		Permiresime			
18.	Programe mesimore	Hartime te reja			
		Permiresime			
19.	Artikuj shkencore ne pub- licistike	Ne revista e gazeta shkencore			
20.	Pjesmarrje ne projekte		4	4	
21.	Studente te perfshire ne projekte, etj		4	4	
22.	Analiza shkencore (re-vieë)		2	2	
23.	Pjesmarrje ne borde editorial periodikesh	Brenda vendit	3		
		Jashte vendit		3	
24.	Recensa shkencore per artikuj shkencore	Brenda vendit			
		Jashte vendit			
25.	Artikuj shkencore derguar per botim ne proces recense	Brenda vendit	4		
		Jashte vendit	2	6	
26.	Pjesemarrjes aktive ne rjetet nderkombetare te kerkimit dhe zhvillimit				
27.	Pjesmarrje ne Juri vlere-simi	Ne Juri Doktoratash (Oponente)			
28.	Studime Postdoktorale	Jashte vendit			
29.	Tituj dhe grada te fituara (ose ne proces)	Profesor			
		Prof.asoc.			
		Dr.			
		Docent			
		Master			

Të dhëna mbi programet e studimit.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programe studimi në të dy ciklet e studimit me kohe te plote.

PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR"			
Nr	Emërtimi i Programit	Cikli i studimit	Forma e studimit
1.	Matematike - Fizike	Cikli i parë	Kohë e plotë
2.	Matematike Informatike	Cikli i parë	Kohë e plotë
3.	Teknologji Informacioni	Cikli i parë	Kohë e plotë
4.	Fizike dhe Teknologji Informacioni	Cikli i parë	Kohë e plotë
5.	Infermieri e Pergjithshme	Cikli i parë	Kohë e plotë
6.	Infermieri Mami	Cikli i parë	Kohë e plotë
7.	Biologji Kimi	Cikli i parë	Kohë e plotë
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË			
1.	Master shkencor në Biologji Mjedis dhe Zhvillimi	Cikli i dytë	Kohë e plotë
2.	Master profesional në shkencat infermiore	Cikli i dytë	Kohë e plotë

Për këtë vit akademik, me Urdhërin nr.271, date 28.08.2020 të MASRështë miratuar hapja e programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional në Shkencat Infermiore.

Fakultetet – IAL-ja informacion mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre.

Nr	Emertimi i programit te studimit	Ne proces vlerësimi	Lloji i programit
1.	Menaxher mjedisi	Ne proces aplikimi	Program studimi profesional

Realizimi i angazhimitte personelit akademik, ngarkesa përkatëse, lëndën/t dhe /ose moduln/et që do jane zhvilluar nga secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik 2019-2020.

Më poshtë pasqyrohet realizimi për ngarkesën mësimore të stafit akademik të FSHN-së sipas Departamenteve / Njësive Bazë gjatë vitit akademik 2019-2020.

Njësia Bazë Matematikë, Informatikë dhe Fizikë

Nr.	Emer	Mbiemer	Kualifikimi (titulli/grada)	Lloji i angazhimit (PAK/PAE)	Departamenti	Programi i studimit	Ngarkesa (në orë)
1	Jani	Dine	Prof.Asoc.Dr	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	60
						2-Bachelor ne Kontabilitet Finance	75
						3-Bachelor ne Arsimin Parashkollor+ Bachelor Arsimi Fillor	30
						4-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor ne Teknologji Informatike	30
						5-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike+Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	90

2	Dhori	Terpo	Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	Totali	285
						1-Bachelor ne Kontabilitet Finance	60
						2-Bachelor ne Biologji Kimi	36
						3-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor ne Teknologji Informacioni	30
						4-Program 2 vjecar Librar dhe Biblotekar	45
						5- Program 2 vjecar Edukatore per zhvillimin e femijerise se hershme 0-3 vjec	75
3	Arben	Isufati	Doc.Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	6-Bachelor ne Gjuhe, Letersi dhe Qyteterim Grek	60
						Totali	306
						1-Bachelor ne Matematike Informatike	45
						2-Bachelor ne Matematike Informatike + Teknologji Informacioni	180
						3-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike+Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	174
						4-Bachelor ne Arsimin Parashkollor	60
4	Krisanthi	Naka	Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	Totali	459
						1-Bachelor ne Matematike Informatike	90
						2-Bachelor ne Matematike Informatike + Teknologji Informacioni	285

						3-Bachelor ne Arsimin Fillor	60
						Totali	435
5	Kastriot	Zoto	Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	105
						2-Bachelor ne Arsimin Parashkollor+ Bachelor Arsimi Fillor	60
						3-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike+Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	90
						4-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor ne Teknologji Informacioni	150
						Totali	405
6	Jani	Lica	Doc.Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	120
						2-Bachelor ne Teknologji Informacioni	150
						5-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike	120
						Totali	390
7	Jollanda	Shara	Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Teknologji Informacioni	270
						2-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike	60
						3-Bachelor ne Gjuhen Angleze	45
						4-Bachelor ne Arsimin Parashkollor	60
						Totali	435

8	Romeo	Mano	Doc.Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	60
						2-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor Teknologji Informacioni	180
						3-Bachelor ne Arsimin Fillor	60
						4-Bachelor ne Administrim Publik + Bachelor ne Turizem	120
						5-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike+Mas ter ne Mesuesi ne Matematike Fizike	84
						Totali	504
9	Kosta	Lili	Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	45
						2-Bachelor ne Teknologji Informacioni	255
						3-Bachelor ne Teknologji Informacioni+ Bachelor ne Fizike Teknologji Informacioni	90
						Totali	390
10	Roland	Vasili	Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	120
						2-Bachelor ne Teknologji Informacioni	60
						3-Bachelor ne Matematike Informatike + Teknologji Informacioni	90



						4-Bachelor ne Administrim Publik + Bachelor ne Turizem	60
						Totali	330
11	Inva	Bilo	Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	45
						2-Bachelor ne Teknologji Informacioni	180
						3-Bachelor ne Infermieri + Bachelor ne Mami	18
						4-Program 2 vjecar Asistent administrativ + Program 2 vjecar Asistent menaxher në shërbime turistike	90
						Totali	333
12	Isidor	Kokalari	Doc.Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1- Bachelor ne Fizike Teknologji Informacioni	60
						2-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike	60
						3-Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	176
						4-Master ne Mesuesi ne Gjuhe Angleze + Master ne Mesuesi ne Gjuhe Italiane	135
						5-Bachelor ne Infermieri + Bachelor ne Mami	18
						Totali	449
13	Antuela	Sinani	Dr.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1- Bachelor ne Fizike Teknologji Informacioni	45

						2-Bachelor ne Biologji Kimi	52.5
						3-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike	56
						4-Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	120
						5-Bachelor ne Matematike Informatike + Teknologji Informacioni	180
						6-Bachelor ne Arsimin Parashkollor	30
						Totali	483.5
14	Idajet	Selmani	Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1- Bachelor ne Fizike Teknologji Informacioni	285
						2-Bachelor ne Arsimin Fillor	30
						Totali	315
15	Besjan	Rama	Msc.	PAE	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1- Bachelor ne Fizike Teknologji Informacioni	210
						2-Bachelor ne Arsimin Parashkollor	30
						3-Bachelor ne Arsimin Fillor	30
						Totali	270
16	Alba	Meleqi	Msc.	PAK	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	60
						2-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor Teknologji Informacioni	60
						Totali	120
17	Arian	Vllaho	Msc.	PAK	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	60
						2-Bachelor ne Teknologji Informacioni	60

						Totali	120
18	Nasi	Kapurani	Msc.	PAK	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	120
						2- Bachelor ne Teknologji Informacioni	30
						Totali	150
19	Kostaq	Hila	Prof.Dr	PAK	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	30
						2-Bachelor ne Matematike Informatike + Bachelor Teknologji Informacioni	30
						3-Master ne Mesuesi ne Matematike Informatike+Master ne Mesuesi ne Matematike Fizike	90
						Totali	150
20	Vasil	Minga	Msc.	PAK	Matematikes, Informatikes dhe Fizikes	1-Bachelor ne Matematike Informatike	105
						Totali	105

Njësia Bazë e Biologjisë dhe Kimisë

Nr.	Emer	Mbiemer	Kualifikimi (titulli/grada)	Lloji i angazhimit (PAK/PAE)	Departamenti	Programi i studimit	Ngarkesa (në orë)
1	SELFO	ORUÇI	Prof.Asoc.Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Inf.Pergj.	100
						Bch. Bio-Kimi +Master b-k	67.5
						Bch.Cu-Edukne zhv e fem	60
						Totale:	222.5
2	SADIK	MALO	Prof.Asoc.Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Bch.PSH	93
						Bch. Bio-Kimi +Master b-k	100
						Infermier-Mami	83
						Totale:	276
3	LAVDI	HASANI	Prof..Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Inf.Pergj.	36
						Bch. Bio-Kimi +Master b-k	273
						Bch CU	33
						Totale:	342
4	MAJLINDA	TERPO	Prof.Asoc.Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Bch.Bio-Kimi	224
						Master ne mesuesi ne b-k	90

						Totale:	314
5	GLIGOR	PASPALI	Prof.Asoc.Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Inf.Pergj.	36
						Bch.Bio-Kimi	147
						Master ne mesuesi ne b-k	42
						Totale:	225
6	ANDUELA	QENDRO	Dr	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Bch.Bio-Kimi	280
						Master ne mesuei Bio-Kimi	45
						Totale:	325
7	ETLEVA	HYSAJ	Dr.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Bch.Bio-Kimi	218
						Master ne mesuei Bio-Kimi	150
						Totale:	368
8	ANETA	ÇOMO	MSc.	PAE	BIOLOGJI-KIMI	Bch.Bio-Kimi	22.5
						Master ne mesuei Bio-Kimi	89.5
						Infermier-Mami	80
						Bch CU+Bch PSH	66
Totale:							248

Njësia Bazë Infermieri

Nr.	Emer	Mbiemer	Kualifikimi (titulli/grada)	Lloji i angazhimit (PAK/PAE)	Programi i studimit	Ngarkesa (në orë)
1	ALTIN	GOXHARAJ	MSc.	PAK / I brendshem	Inf.Pergj.+Mami	132.5
					Infermieri e Pergjithshme	47.4
					Infermier-Mami	77
					Praktika	100
					Totale:	357
2	ARJETA	XHEMALI	MSc.	PAE	Inf.Pergj.+Mami	--
					Infermieri e Pergjithshme	89.5
					Infermier-Mami	140
					Praktika	75
					Totale:	304.5
3	BLEDAR	LATE	M.Egzekutiv	PAE	Inf.Pergj.+Mami	193
					Infermieri e Pergjithshme	142
					Infermier-Mami	57.5
					Praktika	100
					Totale:	492.5
4	DRITAN	RAMI	MSc.	PAE	Inf.Pergj.+Mami	120
					Infermieri e Pergjithshme	145
					Infermier-Mami	25
					Praktika	100

					Totale:	390
5	LAURA	MEZINI	Dr.	PAE	Inf.Pergj.+Mami	118
					Infermieri e Pergjithshme	23.5
					Infermier-Mami	107
					Praktika	50
					Totale:	298.5
6	MARIA	AGOLLI	Prof.Asoc.Dr.	PAE	Inf.Pergj.+ Mami	70
					Inf.Pergj.	58.5
					Bch. Bio-Kimi	96,5
					Bch. Cu (seminare)	30
					Totale:	255
7	ZAMIRA	VLLAHO	Doc.Dr.	PAE	Inf.Pergj.+Mami	170
					Infermieri e Pergjithshme	93.5
					Infermier-Mami	20.5
					Prog. 2-vjec. Femijeri hersh	30
					Praktika	75
					Totale:	389
8	ZHENISA	GRACI	MSc.	PAE	Inf.Pergj.+Mami	101
					Infermieri e Pergjithshme	52
					Infermier-Mami	55
					Praktika	100
					Totale:	308

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit.

Tabela 2 Numri i studentëve që ndjekin programet e studimit në FSHN për vitin akademik 2019-2020

Nr.	PROGRAME TE STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR"	VITI AKADEMIK 2019-2020									
		Regjistruar me kohe te plote									
		Gjithsej	Viti i parë	Femra	Të huaj	Viti i dytë	Femra	Të huaj	Viti i tretë	Femra	Të huaj
1	Matematike – Fizike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Matematike Informatike	32	8	1	0	10	2	1	14	3	0
3	Biologji-Kimi	35	8	6	0	11	6	0	16	7	0
4	Teknologji Informacioni	46	13	2	0	17	2	0	16	2	2
5	Fizike-Teknologji Informacioni	2	0	0	0	0	0	0	2	0	0
6	Infermieri e Pergjithshme	203	77	55	0	71	42	1	55	28	0
7	Infermieri Mami	33	9	9	0	13	13	0	11	11	0

	Gjithësej	351	115	73	0	122	65	2	114	51	2
--	-----------	-----	-----	----	---	-----	----	---	-----	----	---

Përqindja e studentëve kalues në vit dhe përqindja e atyre që diplomohen ;

CIKLI I PARË "BACHELOR" Viti akademik 2019-2020							
Nr.	Programi i studimit	Viti I	Viti II	Viti III	% e studenteve kalues ne vitin I	% e studenteve kalues ne vitin II	% e studenteve kalues ne vitin III që diplomohen
1.	Matematike-Fizike	0	0	1	0	0	0
2.	Matematike-Informatike	6	3	9	75%	30%	64%
3.	Biologji-Kimi	5	10	9	62%	90%	56%
4.	Teknologji Informacioni	6	10	8	46%	58%	50%
5.	Fizike Teknologji Inform	0	0	3	0	0	100%
6.	Infermieri e Përgjithshme	55	65	54	71%	91%	98%
7.	Infermieri Mami	6	11	11	66%	100%	100%
	FSHN diplomuar 95 studen , kalueshmeri 71.6%				64%	73.8%	78%

Vlerësim i përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi.

Përgjithësisht cilësia e studentëve nuk ka qene ne nivelin e pritshmërisë sonë. Studentët e regjistruar në programet e studimit të FSHN, veçanërisht në ato të mësuesisë, janë relativisht të dobët. Kjo vjen edhe prej faktit që në këtë fakultet regjistrohen të ndjekin studimet maturantët, kandidatë për studentë, të një formimi të dobët shkencor. Në shumicën e rasteve, studimet për shkenca natyrore nuk janë zgjedhje e tyre preferenciale. Ndikon këtu dhe vështirësia e lëndëve të profileve natyrore dhe punësimi relativisht jo i preferuar si mësues.

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Selfo ORUÇI

